

AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUARA

“ER.DA COMPANY” shpk

Sot me dt.23.01.2020_ ortaku i vetëm Z. Skender QYTEZA:

Vendosi që në bazë të Ligjit Nr. 9901 datë.14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe Ligjit Nr. 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” formohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “ER.DA COMPANY _” shpk, me cilësinë e Ortakut themelues.

1. **Skender Arian QYTEZA** i datëlindjes **06.07.1997**, me kartë identiteti **J706082B**, lindur në Durrës e banues në Durres, shprehu vullnetin për hartimin e këtij Akt Themelimi të shoqërisë “ER.DA “ shpk si më poshtë:

KREUI

Neni 1

Krijimi

Shoqëria ER.DA COMPANY Shpk është person juridik i të drejtës shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë e quajtur Shoqëria).

Neni 2

Personaliteti juridik

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria shtë një shoqëri tregtare, e themeluar nga Z. Skender QYTEZA, i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku i vetëm gëzon 100 % të kuotës në shoqëri.

Neni 3

Selia

Shoqëria jonë e ka selinë në

Durres, Xhafzotaj, Rruga Nacionale Xhafzotaj-Shijak, Zona Kadastrale 3852, Godine
njekateshe me nr pasurie 164/22.

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Ortakut të vetëm.

Neni 4

Objekti i veprimtarisë

Eksporte, importe mallrat e ndryshem .Import - Eksport dhe Tregti me shumice dhe pakice i produkteve te ndryshme ushqimore industriale, bujqesore. Importin e makinerive te ndryshme si linja prodhimi, makineri bujqesore, elektroshtepiake, pajisje elektrike, elektronike, kompjuteri, produkte metalike, qelqi, ngjitese dhe resine ne pergjithesi, kompozite prej fibre karboni, qeramika, artizanale, sinterizuar, pjese kembimi per automjete apo makineri, etj te ngjashme me keto. Hapje e Bareve, Restoranteve, Hoteleve, dyqaneve tregetar te specializuar ose jo , zyrave per shitjen e sherbimeve te ndryshme. Dhenie me qera, nenqera te ambienteve te ndryshem mjeteve, paisjeve, aktiveve te trupezuara e te pa trupezuara etj te ngjashme me keto. Aktivitetet ne fushen e ndertimit, projektimit, shitjes te objekteve shumekatesh civile, industriale, turistike, bujqesore. Podhim dhe tregtim i materialeve te ndertimit, 2 produkteve turistike, bujqesore, industriale. Kryerjen e transaksioneve me pasurive te luajtshme dhe te paluajtshme etj te ngjashme me keto. Konstrukione metalike, mirembajtje, sherbime hekurudhore dhe mjetesh te renda mekanike te lidhura me hekurudhat. Sherbime pastrimi toksore e detare ,dizifektimi i ambienteve te brendshme dhe te jashtme . Agjensi detare dhe spedicionere. Sherbime portuale.Mirmbajtje skafesh dhe sherbimet e tyre.Mbjellje druresh decorative .Tregtim i farave fidanve dekorativ.

Neni 5

Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë I ndare ne 1 kuote.

Kapitali i mësipërm është nënshkruar nga ortakët e shoqërisë.

Ortaku i Shoqërisë Skender Qyteza gezon 1 kuote në shoqëri, në masën 100 %, ne vleren 10.000 leke.

Kontributi i ortakut mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/ të paluajtshme apo të drejta).

Ortaku përgjigjet për humbjet e shoqërisë përkundrejt të tretëve deri në vlerën e kontributit të tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë
- b) Shitblerjes
- c) Trashëgimisë
- d) Dhurimit
- e) Çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të tranferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi Vendimmarrës

ORTAKU I VETËM është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

ORTAKU I VETËM është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Çdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

ORTAKU I VETËM, vendos për çeshtje si:

- a) Përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë
- b) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve
- c) Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- d) Përcaktimin e shpërblimeve
- e) Mbikqyrjen e politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- f) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- g) Miratimin e rregullave procedural të mbledhjeve të asamblesë.

Të gjitha vendimet e marra nga ORTAKU I VETËM regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- b) Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve
- c) Investime
- d) Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë Skender QYTEZA i datëlindjes 06.07.1997 me kartë identiteti J706082B emëruar në këtë detyrë për një afat_5 vjecar me të drejtë ripertëritje. Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të Asamblesë së Ortakëve të shoqërisë.

Neni 10

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) Kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme
- b) Përfaqësojë shoqërinë tregtare
- c) Kujdeset për mbarëvajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë
- d) Përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim
- e) Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë
- f) Kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit
- g) Raportoje përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare.

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e ortakut të vetëm edhe në rastet kur:

Sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 % të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjithë personave fizikë e juridikë, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të të gjitha shkallëve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve të shoqërisë. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 11

Viti Financiar

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në QKR dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 12

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) Kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj
- b) Me vendim të ortakut të vetëm
- c) Me hapjen e procedurave të falimentimit
- d) Nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit"
- e) Me vendim të gjykatës

Në këtë rast ortaku merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tyre, emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtesë "Shoqëri në likuidim e sipër".

Neni 13

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë akt themelimi dhe dispozitat e legjisllacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë akt themelimi, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specific në Republikën e Shqipërisë.

Neni 14

Dispozita përfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua në 2 kopje me përmbajtje dhe vlera të njejta juridike. Akti i mësipërm pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku themelues i shoqërisë tregtare ER.DA shpk, nënshkruhet në të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmën e tij origjinale.

ORTAKU I VETËM

Skender QYTEZA

Skender Qyteza

